



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE DURRËS



NOTER INES V. ALEKSI
ADRESA NR.11, ALEKSANDER
GOGA
TEL: 692061695

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 2161

Nr. koleksioni: 1178

Durres më 14/06/2023

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2023011920126768299



A2023011920126768299

KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI

Sot, më datë 14.06.2023, para meje Notere INES V. ALEKSI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore DURRËS, me zyrë në adresën Durres, NR.11, ALEKSANDER GOGA, u paraqit personalisht:

SHITES:

Bujar Doda, atësia Hysen, amësia Sabrije, shtetas Shqiptar, lindur në Draç, Durrës dhe banues në Durrës, me adresë R.1"currila"; Nd. 1; H. 1; Ap. 1; Durrës, lindur më 05/09/1957, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036451119 dhe nr. personal F70905001D, .

SHITES:

Nazmie Doda, atësia Shemsi, amësia Mejreme, shtetase Shqiptare, lindur në Shijak, Durrës dhe banuese në Durrës, me adresë R.1"currila"; Nd. 1; H. 1; Ap. 1; Durrës, lindur më 22/05/1959, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 036621422 dhe nr. personal F95522006N, .

BLERES:

Selim Doma, atësia Bajram, amësia Nazmije, shtetas Shqiptar, lindur në Kuraten, Durrës dhe banues në Durrës, me adresë Durrës, lindur më 18/06/1957, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036021931 dhe nr. personal F70618001N, .

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noterja redaktimin e Kontratës së Shitjes së kuotave të kapitalit sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

Shitësit dhe Blerësi do të referohen bashkarisht si ("Palët") dhe secili prej tyre si ("Pala")

KUSHTET PARAPRAKE

- A. Referuar të dhënave nga Regjistri Tregëtar i Qendrës Kombëtare të Biznesit, Ekstraktit datë ____06.2023, (me nënshkrim dhe vulë elektronike), Shoqëria JEDAS sh.p.k, është person juridik shqiptar, me formë ligjore, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me NUIS:K81806505G, me seli në adresën Durrës, Lagje 17, Rr. Dalip Peza, Pallati 978, Shkalla 1, Kati 1, Nr. Pasurie 5/322-N, ZK.8513, e regjistruar në Regjistrin Tregëtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, me status "aktiv", me vlerë kapitali të regjistruar prej Lekë 378.000.000,00, e ndarë në 3(tre) kuota, të cilat zotërohen: Ortaku Dorian Doma zotëron 1 kuotë, me përqindje në kapital 15,00, me vlerë nominale 56.700.000,00; Ortaku Selim Doma zotëron 1 (një) kuotë, me përqindje në kapital 42,50, me vlerë nominale Lekë 160.650.000,00; Ortaku Bujar Doda zotëron 1 (një) kuotë, me përqindje në kapital 42,50, me vlerë nominale Lekë 160.650.000,00.
- B. Referuar të dhënave në të njëjtin ekstrakt, rezulton se në datën e sotme, 1 (një) kuotë që zotëron Ortaku Bujar Doda te kapitali i regjistruar i Shoqërisë JEDAS sh.p.k, me përqindje në kapital 42,50, me vlerë



A2023011920126768299

nominale Lekë 160.650.000,00, është e lirë nga çdo mjet për sigurimin e detyrimeve, si barra siguruese, kolateral, peng apo garanci. Përveç ekstraktit nga QKB, sa më sipër, konfirmohet, edhe nga vërtetimi datë 14 /06/2023, i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Barrëve Siguruese.

- C. Referuar Çertifikatës Familiare të lëshuar nga Zyra e Gjëndjes Civile, Bashkia Durrës, rezulton se Z. Bujar Doda, dhe Znj. Nazmie Doda janë të lidhur në martesë. Z. Bujar Doda, dhe Znj. Nazmie Doda si bashkëshortë deklarojnë para Blerësit, se janë në regjimin pasuror martesor në Bashkësi dhe njëkohësisht konfirmojnë (nëpërmjet deklarimeve dhe nënshkrimit të tyre në këtë kontratë) se të dy së bashku, zotërojnë në bashkëpronësi në pjesë të barabarta, 1 kuotë pjesë përbërëse e kapitali i regjistruar i Shoqërisë JEDAS sh.p.k, me përqindje në kapital 42,50, me vlerë nominale Lekë 160.650.000,00, e cila në regjistrin Tregtar figuron e regjistruar vetëm në emër të Ortaku Bujar Doda.
- A. Shitësit Bujar Doda dhe Nazmie Doda janë dakord që, përkundrejt çmimit të shitjes të parashikuar në këtë kontratë, t'i sheshin Blerësit Selim Doma, 1 kuotë pjesë përbërëse e kapitalit të regjistruar të Shoqërisë JEDAS sh.p.k, me përqindje në kapital 42,50, me vlerë nominale Lekë 160.650.000,00.
- B. Blerësi Selim Doma, nga ana tjetër deklaron se përkundrejt çmimit të parashikuar në këtë kontratë, është dakord t'i blejë Shitësve Bujar Doda dhe Nazmie Doda, 1 (një) kuotë pjesë përbërëse e kapitali i regjistruar i Shoqërisë JEDAS sh.p.k, me përqindje në kapital 42,50, me vlerë nominale Lekë 160.650.000,00.
- C. Për shitjen e kësaj kuote ka dhënë miratimin edhe Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë JEDAS sh.p.k, nëpërmjet Vendimit datë 14 /06/2023.

Shitja e kuotës së referuar më sipër është në përputhje të plotë me LIGJIN NR. 9901, DATE 14.4.2008, "PËR TREGTARËT DHE SHOQËRITË TREGTARE", TË NDRYSHUAR, Neni 73 pika (b), si dhe me Nenet 10 dhe 11 të Statutit të Shoqërisë "JEDAS" Sh.p.k, të cilat parashikojnë se "*Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme midis ortakëve të shoqërisë*". Në zbatim të Nenit 10 të Statutit të Shoqërisë "JEDAS" sh.p.k, Ortaku tjetër i Shoqërisë JEDAS sh.p.k, Z. Dorian Doma, nëpërmjet Deklaratës datë06.2023, ka hequr dorë nga e drejta e parablerjes mbi 1 (një) kuotë pjesë përbërëse e kapitalit të regjistruar i Shoqërisë JEDAS sh.p.k, me përqindje në kapital 42,50, që ka ofruar për shitje Ortaku Bujar Doda. Përfundimisht rezulton se ekzistojnë të gjithë kushtet ligjore për realizimin e shitjes së 1 (një) kuotë pjesë përbërëse e kapitali i regjistruar i Shoqërisë JEDAS sh.p.k, me përqindje në kapital 42,50, me vlerë nominale Lekë 160.650.000,00, në bashkëpronësi të Shitësve.

Palët, pasi kanë rënë paraprakisht dakord ndërmjet tyre dhe duke u bazuar në sa referuar më sipër, ata lidhin këtë Kontratë Shitje të 1,00 Kuote pjesë përbërëse e kapitalit të Shoqërisë JEDAS sh.p.k, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në këtë Kontratë, përfshi ato të parashikuara në dispozitat e zbatueshme të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, si dhe të Ligjit "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare" të ndryshuar, përkatësisht:

2. PASURIA QË SHITET

2.1 Pasuria që shitet nëpërmjet kësaj Kontrate Shitje është:

- a) 1 (një) kuotë pjesë përbërëse e kapitali të regjistruar të Shoqërisë JEDAS sh.p.k, (e identifikuar me NUIS:K81806505G) me përqindje në kapital 42,50, me vlerë nominale LËKË 160.650.000,00, e cila është në bashkëpronësi në pjesë të barabarta të Shitësve Bujar Doda dhe Nazmie Doda, e referuar në këtë kontratë edhe si ("1,00 Kuotë e Shitësve").

3. SHITJA DHE KALIMI I PRONËSISË SË KUOTËS (Objekti i Kontratës)



- 3.1 Shitësit, nëpërmjet kësaj Kontrate Shitje, i shesin, i kalojnë dhe i transferojnë Blerësit, njëqind përqind të titullit të pronësisë mbi 1 (një) kuotë pjesë përbërëse e kapitalit të regjistruar të Shoqërisë JEDAS sh.p.k, me përqindje në kapital 42,50, dhe me vlerë nominale Lekë 160.650.000,00.
- 3.2 Me nënshkrimin e kësaj kontrata bëhet transferimi i pjesës së kapitalit nga shitësi tek blerësi dhe rrjedhimisht krijohen efektet ligjore sa vijon:
- a) Shitësit zhvishen plotësisht, menjëherë, përfundimisht dhe në mënyrë të përvokueshme, nga njëqind përqind e titullit të pronësisë mbi gjithësej 1 (një) kuotë pjesë përbërëse e kapitalit të regjistruar të Shoqërisë JEDAS sh.p.k, me përqindje në kapital 42,50 dhe me vlerë nominale Lekë 160.650.000,00, si dhe nga çdo e drejtë tjetër e lidhur me kuotën pa asnjë përjashtim apo kufizim. Njëkohësisht, Shitësit humbin njëherësh, plotësisht, përfundimisht, në mënyrë të përvokueshme dhe pa asnjë përjashtim apo kufizim, edhe cilësinë Ortak i Shoqërisë JEDAS sh.p.k.
 - b) Nga ana tjetër, Blerësi, fiton menjëherë, plotësisht, përfundimisht dhe në mënyrë të pakufizuar, njëqindpërqind të titullit të pronësisë mbi 1 (një) kuotë pjesë përbërëse e kapitalit të regjistruar të Shoqërisë JEDAS sh.p.k, me përqindje në kapital 42,50 dhe me vlerë nominale Lekë 160.650.000,00, si dhe mbi çdo të drejtë të lidhur me këtë kuotë, duke u zotëruar 2 (dy) kuota të kapitali i Shoqërisë JEDAS sh.p.k, me përqindje në kapital 85%, me vlerë nominale LEKË 321,300,000.

4. ÇMIMI I SHITJES

- 4.1 Çmimi i shitjes së njëqindpërqind të titullit të pronësisë mbi 1 (një) kuotë pjesë përbërëse e kapitalit të regjistruar të Shoqërisë JEDAS sh.p.k, me përqindje në kapital 42,50, me vlerë nominale Lekë 160.650.000,00, nga shitësit te Blerësi, përbëhet nga shuma totale prej LEKË 88,422,281 (Tetëdhjetë e tetë milion e katërqindë e njëzetë dy mijë e dyqindë e tetëdhjetë e një Lekë), i cili do të referohet kudo në këtë kontratë si ("Çmimi i Shitjes së 1 Kuote").
- 4.2 Shitësit deklarojnë dhe garantojnë Blerësin se Çmimi Total i Shitjes së 1 (një) Kuote të shoqërisë JEDAS sh.p.k, sipas përcaktimeve në klauzolën (4.1), është caktuar në mënyrë përfundimtare dhe është i pandryshueshëm dhe i përvokueshëm nga palët e kësaj Kontrate. Duke filluar nga nënshkrimi i kësaj Kontrate nga Palët, Shitësit nuk kanë dhe nuk do t'u njihet asnjë të drejtë për të ngritur asnjë pretendim të çfarëdolloji, në lidhje me vlerën totale të çmimit të shitjes.

5. PAGIMI I ÇMIMIT TË SHITJES

- 5.1 Pagimi i çmimit të shitjes së 1 Kuote, nuk do të behet në para për vlerën e blerjes së kuotes nga blerësi, por do të bëhet nga Blerësi nëpërmjet Kompesimit përkatësisht:
- 5.2 Blerësi do të shlyejë detyrimin e tij ndaj Shitësve për pagimin e çmimit të shitjes së 1 (një) kuote (pjesë përbërëse e kapitali i regjistruar i Shoqërisë JEDAS sh.p.k, me përqindje në kapital 42,50%), të përbërë nga vlera totale prej LEKË 88,422,281, nëpërmjet Kompesimit të këtij detyrimi të Blerësit sipas Neneve 514-523 të Kodit Civil, me detyrimet ekzistuese dhe të kërkueshme që Shitësit kanë ndaj Blerësit, në vlerën e njëjtë prej LEKË 88,422,281, dhe të përshkruara sa vijon:

- a) Detyrimi i pashlyer dhe i kërkueshëm me vlerë prej LEKË 26,300,000 (Njëzetë e gjashtë milion, e trëqindë mijë lekë) që Shitësit kanë ndaj Blerësit, për pagimin e çmimit të shitjes së Apartament dhe dy Vëndparkime, sipas Kontratës së Shitjes për Fitimin në të Ardhmen të Pronësisë mbi Pasuritë e



A2023011920126768299

Paluajtshme, datë 14/06/2023, rep. 2158, kol. 1175, lidhur ndërmjet Shoqërisë JEDAS sh.p.k dhe Bujar Doda dhe Nazmie Doda, dhe e noterizuar nga Noter INES ALEKSI

- b) Detyrimi i pashlyer dhe i kërkueshëm me vlerë prej LEKË 37,500,000 (Tridhjetë e shtate Milion e pesëqinde mijë Lekë), që Shitësit kanë ndaj Blerësit, për pagimin e çmimit të shitjes së Apartament dhe dy Vëndparkime, sipas Kontratës së Shitjes për Fitimin në të Ardhmen të Pronësisë mbi Pasuritë e Paluajtshme, datë 14/06/2023, rep. 2160; kol. 1177, lidhur ndërmjet Shoqërisë JEDAS sh.p.k dhe Bujar Doda dhe Nazmie Doda, dhe e noterizuar nga Noter INES ALEKSI
- c) Detyrimit të pashlyer dhe të kërkueshëm me vlerë prej LEKË 11,900,000 (njembedhjetë Milione e nentëqinde mijë LEKË) që Shitësit kanë ndaj Blerësit, për pagimin e çmimit të shitjes së dy Apartamenteve dhe një Vëndparkimi, sipas Kontratës së Shitjes për Fitimin në të Ardhmen të Pronësisë mbi Pasuritë e Paluajtshme, datë 14/06/2023 rep. 2159; kol. 1176, lidhur ndërmjet Shoqërisë JEDAS sh.p.k dhe Bujar Doda dhe Nazmie Doda, dhe e noterizuar nga Noter INES ALEKSI
- d) Detyrimit të pashlyer dhe të kërkueshëm me vlerë totale prej LEKË 12,722,281 (dymbjëdhjetë million, e shtateqinde e njetete e dy mijë e dyqinde e tetëdhjetë e një LEKË), që Shitësi Bujar Doda ka krijuar në vite si detyrime ndaj Shoqërisë JEDAS sh.p.k, dhe të rikonfirmuar së fundmi nëpërmjet Deklaratë Noteriale, datë 14/06/2023 rep. 215L; kol. 1170, noterizuar nga Noter INES ALEKSI.
- 5.4 Detyrimet e referuara mësipër në Klauzolat (5.2, paragrafët a,b,c,d,e), Shitësit i kanë krijuar fillimisht ndaj Shoqërisë JEDAS sh.p.k, ndërsa në bazë të Kontratës për Kalim Kredie datë 14/06/2023 rep. 2153, kol. 1172, të lidhur ndërmjet Shoqërisë JEDAS sh.p.k, Selim Doma dhe Bujar Doda, të gjithë të drejtat që ka zotëruar më parë Shoqëria JEDAS sh.p.k, në lidhje me detyrimet ndaj saj të Bujar Doda, i ka kanë kaluar kreditorit Selim Doma.
- 5.5 Shitësit, deklarojnë se janë dakord dhe pranojnë plotësisht dhe pa asnjë rezervë kompesimin e detyrimeve ndërmjet tyre dhe Blerësit, sipas parashkimeve në Klauzolat (5.2, paragrafët a,b,c,d,e), dhe për efekte të shlyerjes së plotë të detyrimit të Blerësit ndaj Shitësve për pagimin e çmimit të shitjes së një kuote së 1 (një) kuote pjesë përbërëse e kapitali i regjistruar i Shoqërisë JEDAS sh.p.k, me përqindje në kapital 42,50, të kësaj Kontrate.
- 5.6 Nga ana tjetër, Blerësi, deklaron se është dakord dhe pranon plotësisht dhe pa asnjë rezervë kompesimin e detyrimeve ndërmjet tij dhe Shitësve, sipas parashkimeve në Klauzolat (5.2, paragrafët a,b,c,d,e), dhe për efekte shlyerjes së detyrimeve që Shitësit i kanë Blerësit në bazë të akteve të përshkuara në Klauzolën (5.2, paragrafët a,b,c,d,e) të kësaj Kontrate.
6. REGJISTRIMI I KONTRATËS NË QËNDRËN KOMBËTARE TË BIZNESEVE
- 6.1 Shitësit dhe Blerësi autorizojnë regjistrimin e kësaj Kontrate Shitje në Regjistrin Tregtar pranë Qëndrës Kombëtare të Biznesit për efekt të regjistrimit të kalimit të titullit të pronësisë mbi një 1 (një) kuotë pjesë përbërëse e kapitalit të regjistruar të Shoqërisë JEDAS sh.p.k, me përqindje në kapital 42,50, nga Shitësit te Blerësi dhe regjistrim e titullit mbi këtë kuotë në pronësi të Blerësit.



A2023011920126768299

6.2 Shitësit dhe Blerësi, bien dakord që vlefshmeria e kalimit të titullit të pronësive mbi 1 (një) Kuotë të kapitalit të Shoqërisë JEDAS sh.p.k, që shitet nëpërmjet kësaj kontrate, nuk do të kushtëzohet nga kryerja e formaliteteve të ndryshme me efekt deklarativ, përfshi këtu formalitetet e regjistrimit ose të publikimit të kësaj kontrate shitje apo të kalimit të titullit të pronësië mbi 1 (një) Kuotë.

7. TAKSAT DHE TATIMET

- 7.1 Të gjitha detyrimet që lindin nga ky transaksion të Z. Bujar DODA për vlerën e blerjes së pasurive (ekuivalente me vlerën e shitjes së aksioneve) do të shlyhen nga blerësi Z. Selim DOMA.
- 7.2 Blerësi merr përsipër dhe në ngarkim të Blerësit do të jetë çdo detyrim i krijuar kurdoherë deri para datës së lidhjes së kësaj kontrate shitje, për pagimin e çdo shume tatimi/takse të zbatueshme në lidhje me 1 (një) kuotë pjesë përbërëse e kapitali i regjistruar i Shoqërisë JEDAS sh.p.k. Blerësi do të jetë i detyruar të bëjë pagimin e detyrimit të shprehur mësipër në këtë paragraf, në çdo rast në të ardhmen kur të bëjë shperndarje fitimi nga kapitali.
- 7.3 Shitësit janë përgjegjës për kryerjen në kohë të çdo deklarimi pranë Organeve Tatimore apo Organeve të tjera shtetërore, përsa i përket faktit të lidhjes së kësaj kontrate shitje.

8. DEKLARIMET DHE GARANCITË E PALËVE

8.1 Deklarimet dhe Garancitë e Shitësve. Shitësit në mënyrë të përbashkët dhe individuale deklarojnë dhe i japin Blerësit garancitë sa vijon:

- a) Shitësit janë të vetmit bashkëpronarë që zotërojnë njëqind përqind të titullit të pronësisë si dhe të çdo të drejte tjetër të lidhur me të, mbi 1 (një) kuotë pjesë përbërëse e kapitalit të regjistruar të Shoqërisë JEDAS sh.p.k, referuar mësipër në Klauzolën (2.1, paragrafi a), dhe se anjë palë e tretë nuk zotëron të drejtën e pronësisë apo ndonjë të drejtë tjetër të lidhur me këtë kuotë, pa asnjë përjashtim apo kufizim.
- b) Shitësit gjithashtu garantojnë Blerësin se kanë të gjitha të drejtat dhe kompetencat e nevojshme për të lidhur këtë kontratë shitje me Blerësin dhe për të përmbushur të gjitha detyrimet e tyre si palë shitëse, ndaj Blerësit. Shitësit kanë fituar të drejtën e pronësisë dhe çdo të drejtë tjetër të lidhur me të, mbi 1 (një) kuotë pjesë përbërëse e kapitalit të regjistruar të Shoqërisë JEDAS sh.p.k, referuar mësipër në Klauzolën (2.1, paragrafi a), në bazë ligjeve të kohës dhe nëpërmjet dokumentave që përbëjnë titull pronësie të vlefshëm, të cilat nuk janë anuluar asnjëherë dhe që edhe në datën e sotme vazhdojnë të përbëjnë titull pronësie të vlefshëm dhe ligjor. Asnjë Palë e Tretë, pa asnjë përjashtim apo kufizim, duke filluar nga data e themelimit dhe regjistrimit të Shoqërisë JEDAS sh.p.k, e deri në datën e sotme, nuk ka fituar të drejtën e pronësisë apo ndonjë të drejtë tjetër në lidhje me 1 (një) kuotë pjesë përbërëse e kapitalit të regjistruar të Shoqërisë JEDAS sh.p.k, referuar mësipër në Klauzolën (2.1, paragrafi a), si dhe asnjë palë e tretë nuk ka ngritur asnjëherë, përfshi aktualisht, asnjë pretendim pronësie mbi kotën, në rrugë jashtëgjyqësore, administrative, apo gjyqësore.
- c) Shitësit deklarojnë dhe garantojnë Blerësin se 1 (një) kuotë pjesë përbërëse e kapitalit të regjistruar të Shoqërisë JEDAS sh.p.k, referuar mësipër në Klauzolën (2.1, paragrafi a), në datën e sotme është e lirë nga çdo mjet për sigurimin e detyrimeve, si barrë siguruuese, garanci, peng, kolateral për kredimarrje, detyrim ligjor apo kontraktor i çfarëdolloji, dhe se nuk janë objekt i ndonjë konflikti dhe procesi gjyqësor civil, penal, administrativ apo procedimi penal, apo objekt i ndonjë lloj veprimi ligjor, padie, pretendimi të çfarëdolloji kundrejt shitësave, kufizimesh apo të çdo lloji tjetër, pa asnjë kufizim



A2023011920126768299

apo përjashtim, të cilat çënojnë, rrezikojnë apo prekin në çfarëdo mënyre, vlefshmërinë e të drejtës së pronësisë së Shitësve apo të drejta të tjera të lidhura mbi 1 (një) kuotë pjesë përbërëse e kapitalit të regjistruar të Shoqërisë JEDAS sh.p.k, referuar mësipër në Klauzolën (2.1, paragrafi a). Gjithashtu Shitësit deklarojnë dhe garantojnë Blerësin se në lidhje me 1 (një) kuotë pjesë përbërëse e kapitalit të regjistruar të Shoqërisë JEDAS sh.p.k referuar mësipër në Klauzolën (2.1, paragrafi a), në datën e sotme nuk ekziston asnjë detyrim monetar apo i çfarëdo lloji tjetër, i papaguar apo i papërbushur nga Shitësit, ndaj kujdo pale të tretë, përfshi ndaj Shtetit, pa asnjë përjashtim apo kufizim.

- d) Shitësit deklarojnë dhe garantojnë Blerësin se në datën e sotme, nuk ekziston asnjë Kontratë e vlefshme dhe në fuqi, të tilla si por pa u kufizuar te kontrata shitje, premtim shitje, kontrata paraprake, përfundimtare apo me rezervë, të lidhura ndërmjet Shitësve dhe kujdo pale tjetër pas asnjë përjashtim apo kufizim, për shitjen dhe kalimin e pjesëshëm apo të plotë të të drejtës së pronësisë apo të çdo të drejte tjetër, mbi 1 (një) kuotë pjesë përbërëse e kapitali i regjistruar i Shoqërisë JEDAS sh.p.k, referuar mësipër në Klauzolën (2.1, paragrafi a), të kësaj Kontrate.
- e) Shitësit deklarojnë dhe garantojnë se 1 (një) kuotë pjesë përbërëse e kapitalit të regjistruar të Shoqërisë JEDAS sh.p.k, referuar mësipër në Klauzolën (2.1, paragrafi a), në datën e sotme, nuk është objekt të drejtash, interesash, detyrimesh, kufizimesh, kushtesh, marrëveshesh, premtimesh, apo të llojeve të tjera, të drejta kalimi në favor të ndonjë pale të tretë, apo ndonjë të drejtë tjetër ose marrëveshje zyrtare apo jozyrtare.
- f) Përgjatë të gjithë periudhës nga data e fitimit të të drejtës së pronësisë (titullit të pronësisë) dhe pa ndërprerje në vazhdim, deri në datën e sotme, Shitësit kanë paguar të gjitha detyrimet ligjore, në formë taksash, tatimesh apo të çdo lloji tjetër të lindura atyre për shkak të zotërimit të të drejtës së pronësisë, mbi 1 (një) kuotë pjesë përbërëse e kapitali i regjistruar i Shoqërisë JEDAS sh.p.k, referuar mësipër në Klauzolën (2.1, paragrafi a), të kësaj Kontrate.
- g) Shitësit deklarojnë dhe garantojnë Blerësin, se përveç 1 (një) kuotë pjesë përbërëse e kapitalit të regjistruar të Shoqërisë JEDAS sh.p.k, referuar mësipër në Klauzolën (2.1, paragrafi a), ata nuk zotërojnë asnjë të drejtë pronësie, të drejta përfitimi apo të ndonjë lloji tjetër, pa asnjë përjashtim apo kufizim, mbi kapitalin e Shoqërisë JEDAS sh.p.k, mbi çdo aset tjetër të luajshëm apo të paluajshëm që zotëron aktualisht në pronësi Shoqëria JEDAS sh.p.k, mbi çdo çfarëdo investimi të kryer kurdoherë nga Shoqëria JEDAS sh.p.k, mbi kapitalet e veta të shoqërisë, si dhe mbi asnjë të drejtë përfitimi që kjo shoqëri ka në bazë të kontratave të lidhura me këdo palë të tretë.
- h) Shitësit deklarojnë dhe garantojnë Blerësin, se për periudhën nga themelimi dhe regjistrimi i Shoqërisë JEDAS sh.p.k, dhe deri në datën e sotme, ata nuk kanë asnjë shumë dividendi të vendosur për t'u shpërndarë ortakeve, të cilën Shitësit nuk e kanë përfituar apo terhequr nga Shoqëria JEDAS sh.p.k. Gjithashtu në lidhje me periudhën e referuar në këtë paragraf, shitësit deklarojnë se ata nuk ka asnjë të drejtë të papërfitur apo për të përfituar në lidhje me çfarëdo investimi apo kontributi të dhënë prej tyre kurdoherë dhe në çfarëdo forme, te kapitali i Shoqërisë JEDAS sh.p.k, dhe te të gjitha asetet, investimet dhe aktivitetet e kësaj shoqërie, pa asnjë përjashtim apo kufizim, përfshi asnjë detyrim të pashlyer të krijuar kurdoherë nga marrëdhëniet e tyre të punës me Shoqërinë JEDAS sh.p.k. Gjithashtu Shitësit deklarojnë se në datën e sotme, Shoqëria JEDAS sh.p.k, nuk kanë asnjë detyrim monetar apo kredi të pakthyer ndaj tyre, për shi interesa kredie, kamatë vonesa, apo shuma për kompesim apo dëmshpërblim ndaj tyre.
- i) Kjo kontratë përbën detyrim ligjor për Shitësit dhe njëlloj edhe për pasardhësit e tyre.
- j) Edhe pas nënshkrimit të kësaj kontrate dhe kurdoherë pakufizim kohor në të ardhmen, Shitësit mbeten përgjegjës para Blerësit dhe marrin përsipër të dëmshpërblejnë Blerësin në vlerën e plotë të dëmit të pësuar nga ky i fundit, kur ndodh (vetëm nëse do të ketë një rast të tillë), se deklarimet dhe



A2023011920126768299

garancitë e bëra nga shitësit për Blerësin në kontratë kanë qënë të pavërteta, pjesërisht apo plotësisht apo kur ndodh se për çfarëdolloj motivi apo shkaku, Shitësit kanë dështuar të përmbushin apo të mbajnë të vlefshme garancitë që i japin Blerësit nëpërmjet kësaj kontrate dhe në lidhje me 1 (një) kuotë pjesë përbërëse e kapitalit të regjistruar të Shoqërisë JEDAS sh.p.k, referuar mësipër në Klauzolën (2.1, paragrafi a), të kësaj Kontrate.

- k) Shitësi, Bujar Doda, deklaron se Kredia ekzistuese që Blerësi ka ndaj Bujar Doda në shumën totale prej LEKË 88,422,281 (Tetëdhjetë e tetë milion e katërqindë e njëzetë dy mijë e dyqindë e tetëdhjetë e një Lekë), , e cila është përfituar nga Blerësi Selim Doma, në bazë të Kontratës për Kalimin e Kredisë datë 14/06/2023 rep 2153/1172, të lidhur ndërmjet Palëve, Shoqërisë JEDAS sh.p.k, Selim Doma dhe Bujar Doda para Noter Ines Aleks,, përbën një detyrim të vlefshëm dhe të papaguar deri në datën e sotme nga Bujar Doda, dhe si e tillë, kjo shumë detyrimi është plotësisht e vlefshme për të bërë kompesimin sipas parashikimeve në Klauzolën (5.1, paragrafët a, b,c,d,e), të kësaj Kontrate.

8.2 Deklarimet dhe Garancitë e Blerësit

- a) Blerësi deklaron dhe garanton shitësit se ka të gjitha kompetencat për të lidhur këtë kontratë dhe për të zbatuar të gjitha detyrimet që i rrjedhin prej saj ndaj Shitësve.
- b) Kjo kontratë përbën detyrim ligjor për blerësin dhe pasardhësit e tij.
- c) Blerësi do të paguajë të gjitha shpenzimet për regjistrimin e kësaj Kontrate në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

9. PENALITETE

9.1 Shitësit marrin përsipër ndaj Blerësit që në rast se kurdoherë në të ardhmen do të ndodhte që nëpërmjet një vendimi gjykate të formës së prerë apo një vendimi të një Organi kompetentet Shtetëror, të vërtetohej se Shitësit nuk kanë qënë pronarë të ligjshëm për një pjesë apo mbi të gjithë 1 (një) kuotë pjesë përbërëse e kapitali i regjistruar i Shoqërisë JEDAS sh.p.k, referuar mësipër në Klauzolën (2.1, paragrafi a), duke përcaktuar njëkohësisht se e drejta e pronësisë mbi këtë Kuotë i përket kujdo pale të tretë (pjesërisht ose plotësisht), atëherë Shitësit, duke filluar nga e marrjes së formës së prerë së Vendimeve të tilla Gjyqësore apo të Organeve Shtetërore kompetente, (me të cilin e drejta e pronësisë i është njohur një pale të tretë), detyrohen ndaj Blerësit sa më poshtë vijon:

- a) Shitësit detyrohen t'i kthejnë menjëherë Blerësit të gjithë shumën e përfituar të çmimit total të shitjes së 1 (një) kuotë pjesë përbërëse e kapitali i regjistruar i Shoqërisë JEDAS sh.p.k, referuar mësipër në Klauzolën (2.1, paragrafi a), sipas kësaj kontrate shitje.
- b) Shitësit detyrohen t'i paguajnë menjëherë Blerësit një shumë të barabartë me diferencën ndërmjet shumës së çmimit të shitjes të përcaktuar në këtë kontratë, dhe shumës së vlerës së tregut që do të ketë 1 (një) kuotë pjesë përbërëse e kapitalit të regjistruar të Shoqërisë JEDAS sh.p.k, referuar mësipër në Klauzolën (2.1, paragrafi a), në kohën e daljes së një vendimi të tillë nga Organi Gjyqësor apo Shtetëror, siç referuar mësipër;
- c) Shitësit, përveç sa parashikuar mësipër në (9.1/a,b), detyrohen t'i paguajnë menjëherë Blerësit edhe çdo shumë tjetër dëmi që do të rezultojë se do të jetë shkaktuar Blerësit si rezultat i sa mësipër, nëse do të ketë të tilla, sipas dakordësimi të palëve ose një Vendimi përkatës nga Gjykata kompetente.

10. TË NDRYSHME



- 10.1 Përveç sa nuk parashikohet në këtë Kontratë do të zbatohen dispozitat e zbatueshme të Kodit Civil Shqiptar dhe të Ligjit Nr. 9901, DATE 14.4.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" të ndryshuar.
- 10.2 Çdo ndryshim i kësaj Kontrate do të jetë i vlefshëm dhe do të prodhojë efekte ligjore për palët, vetëm nëse është bërë me shkrim, i referohet në mënyrë specifike kësaj Kontrate dhe është nënshkruar në mënyrë të rregullt nga të gjitha Palët e kësaj Kontrate.
- 10.3 Pavarësia e Dispozitave: Nëse në ndonjë moment të caktuar një dispozitë e kësaj Kontrate bëhet e pavlefshme apo e pazbatueshme, atëherë kjo dispozitë do të konsiderohet e shkëputur nga kjo Kontratë dhe nëse është e mundur dhe e lejueshme do të zëvendësohet me një dispozitë të ligjshme e cila shpreh në mënyrë sa më të përafërt qëllimin e Palëve sipas kësaj Kontrate pa ndikuar apo shkaktuar pasoja negative mbi vlefshmërinë apo zbatueshmërinë e dispozitave të tjera të kësaj Kontrate.
- 10.4 Ligji i zbatueshëm është ligji shqiptar. Palët bien dakord që çdo mosmarrëveshje që lind në lidhje me vlefshmërinë, interpretimin apo zbatimin e Kontratës të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor kompetente.
- 10.5 Kësaj Kontrate i bashkëngjiten dhe do të jenë pjesë e pandarë e saj:
- Dokumenta identifikues për Palët;
 - Ekstrakt nga Regjistri Tregëtar i Qendrës Kombëtare të Biznesit, me nënshkrim dhe vulë elektronike.
 - Vertetim nga Zyra e Rregjistrimit të Barrëve Siguruese.
 - Çertifikatës Familjare e Shitësve, e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Bashkia Durrës, me nënshkrim dhe vulë elektronike.
- 10.6 Kjo Kontratë hartohet në katër kopje origjinale, secila me vlerë të njëjtë.
- 10.7 Shitësit dhe Blerësit deklarojnë se e kuptojnë plotësisht dhe se janë dakord pa asnjë vërejtje apo kundërshti, me përmbajtjen dhe të gjitha kushtet dhe afatet e kësaj kontrate, dhe se ato përputhen plotësisht me vullnetin e tyre të lirë. Shitësit dhe Blerësi nënshkruajnë këtë Kontratë Shitje duke dashur që të krijojnë të gjitha efektet ligjore të parashikuara në përmbajtjen e saj.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Kontrata e Shitjes të kuotave të kapitalit u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese; të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.

Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

PALËT KONTRAKTUESE

SHITES

Bujar Doda

Nazmie Doda

Bujar Doda 


Nazmie Doda 

Notere
INES V. ALEKSI



A2023011920126768299

BLERES

Selim Doma

Selim Doma 


